



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.696/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Dorofix shpk, me seli ne fshatin Stankoc Komuna e Glllogocit, te cilin e përfaqëson J.P., kundër debitorit N.P.N Hoxha me adresë ne Prizren, me pronar B.K.H., te cilin me autorizim e përfaqëson av. S.G. nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.952/2020 datës 15.04.2022, me datën 31.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit N.P.N Hoxha me adresë ne Prizren, me pronar B.K.H., ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.952/2020 i datës 15.04.2022 dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr. 952/2020 dt.15.04.2022, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.P.N Hoxha me adresë ne Prizren, me pronar B.K.H., i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.1100/2020 dt.20.11.2020, të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri nga Peja,,dhe të njëjtin e ka lënë në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes e dispozitave te procedurës kontestimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës së dytë të aprovoj këtë ankesë si te bazuar dhe aktvendimin e gjykatës e shkallës së parë ta anuloj ashtu që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Dorofix shpk, me seli ne fshatin Stankoc Komuna Gllogoc, te cilin e përfaqëson Jeton Podrimaj, më datën 20.11.2020, ka paraqitur propozim për përmbardim ndaj debitorit N.P.N "Hoxha" me adresë ne Prizren, me pronar B.K.H., në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.196/19 dt.23.07.2019. Përmbarduesi Privat Fatos Shatri nga Peja, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbardimor P.nr.1100/20 dt.20.11.2020, ka lejuar përmbardimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t'i paguaj shumën prej 672.00 euro brenda afatit prej 7 ditësh.

Kundër urdhrin përmbardimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 03.12.2020 duke deklaruar se përmbarduesi privat urdhrin për përmbardim ia ka dërguar debitorit dhe se për secilën faturë ka përpiluar propozim dhe me urdhër ka caktuar përmbardimin. Nga përmbajtja e faturës rrjedh se materiali i faturuar është i periudhës kohore Qershor, Korrik dhe Gusht 2019, debitori e njofton gjykatën se ne këtë periudhe kohore nuk kishte krijuar asnjë raport detyrimi kreditor-debitor. Faturat si dokumente te besueshme nuk i përmbajnë te dhënat e tjera pos llojit dhe sasisë se mallit dhe vlerës se mallit, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta abrojoj urdhrin për përmbardim.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.952/2020 dt.15.04.2022 me të cilin e ka Refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbardimor, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar se pretendimi i debitorit se nënshkrimi i faturës nuk është bërë nga personi i autorizuar i debitorit dhe se debitori nuk merret me punët e shërbimet e theksuara ne faturë janë te pabazuara dhe nuk kanë asnjë justifikim juridik, konkretisht fatura si dokument i besueshëm rezulton se është i nënshkruar nga te dyja palët, vlerëson se propozimi për përmbardim përmban te gjitha elementet e parapara me nenin 38 par.1 të LPP, andaj pretendimet e palës debitore janë te pabazuara. Provat e prezantuara nga debitori nuk provojnë apo arsyetojnë e asnjërin nga shkaqet e përcaktuara me dispozita ligjore te LPP nga neni 69 pasr.4 te LPP, andaj edhe ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale -Dhomat e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së lidhur me nenin 38 paragrafi 1 dhe 2 dhe 43 paragrafi 4 e lidhur me nenin 102.1 të LPK-së.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore me rastin e vendosjes. Në një situatë të tillë gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që të vlerësoj nëse janë përmbushur prezumimet lidhur me përmbajtjen dhe dokumentet që duhet ti bashkëngjiten propozimit për përmbartim, pasi që sipas dispozitës së nenit 38 të LPP-së, parashihet se propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë: *“kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*, ndërsa me paragrafin 2 të nenit 38 përcaktohet se: *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënime të kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ndërsa me dispozitën e nenit 102.1 të LPK-së përcaktohet se: “Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”*.

Në rastin konkret kjo gjykatë, vlerëson se kreditori Propozimin për përmbartim datës 20.11.2020 e ka bazuar në faturën nr.196/2019 dt.23.07.2019 ndërsa në fakt këtij propozimi i ka bashkëngjitur faturën nr.180/2019 datës 10.07.2019, e të cilin fakt gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar në trajtim, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 102.1 të LPK-së. Më tej gjykata nuk mund të vërtetoj se si gjykata e shkallës së parë ka identifikuar faktin se nënshkrimi i faturës përmbartimore 180/19 dt.10.07.2019, është nënshkruar nga debitori përkatësisht përfaqësuesi i autorizuar i debitorit.

Nën këto rrethana, Dhomat e shkallës së dytë, gjeti se vendimi i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë duhet anuluar, me qëllim që në ri procedurë dhoma e shkallës së parë ti evitohet shkeljet e dispozitave të procedurës përmbartimore nga neni 38 paragrafi 1 dhe 2, dhe neni 43 të LPP-së, e njëjta udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura si më lartë, ashtu që të vlerësoj se a janë plotësuar prezumimet procedurale të përcaktuara me dispozitat e sipërcituara e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.696/23 me datë 31.01.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha